



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 7608 prot.,

Vlorë, më 17.05 .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ 2024

**PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT DHE TË VLERËS SË PRIVATIZIMIT TË BANESËS SHTETËRORE TË PAPRIVATIZUAR**

Këshilli i Bashkisë, në bazë të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore », neni 8/2, neni 9 pika 1.1/b,c, neni 30/2, neni 54 pika e,n, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social » të ndryshuar, neni 77/1,a të VKM Nr.179 datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara” dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”, pasi mori në shqyrtim e materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike ;

**V E N D O S I**

1. Të miratojë privatizimin e banesës shtetërore të paprivatizuar për shtetasit me të dhëna sipas tabelës së mëposhtme.
2. Të miratojë vlerën e apartamentit, që do të privatizojnë këta shtetas.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, neni 55, pika 6

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.banese	Nr.pasurie	Struktura e apartamentit	Sipërfaqja / m2	Viti i ndërtimit	Vlera e plotë e privatizimit ( lekë)
1	Trashëgimta - rret e	Ramadan	Mamanaj	871	32/134, ZK 8604	1 dhomë	18	1948	123 696



KRYETAR

Ermal Dredha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

## RELACION

Mbi projekt-vendimin "Për miratimin e privatizimit dhe të vlerës së privatizimit të banesës shtetërore të paprivatizuar"

Në Bashkinë Vlorë ka paraqitur kërkesën për privatizimin e banesës shtetërore të paprivatizuar shtetasja Merfa Mamanaj, bashkëshortja e Ramadan Mamanaj, që ka ndërruar jetë. Në bazë të kontratës së qirasë me shtetin para vitit 1992 "Akti i dhënies dhe i marrjes në përdorim të banesës shtetërore" familja e tyre ka qenë strehuar në një dhomë në banesën nr.871 që ndodhet në lagjen "1Maji", rruga "Irakli Pylli", Rajoni nr.4, Vlorë. Për arsye të ndryshme kjo familje nuk e ka privatizuar këtë banesë, në të cilën ka jetuar në vite dhe jeton aktualisht.

Bazuar në ligjin nr.22/2018 datë 03.05.2018 «Për strehimin social» neni 77/1,a, në VKM Nr.179 datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara" dhe i ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", për të kryer procedurat e privatizimit pranë Bashkisë Vlorë kjo shtetase ka paraqitur dokumentacionin si vijon :

- 1.Kontrata e qirasë me shtetin para vitit 1992 .
2. Çertifikatë familjare e 1.12.1992 dhe çertifikatë familjare aktuale.
3. Planimetri dhe plan rilevimi të banesës.
4. Dëshmi e trashëgimisë ligjore e hartuar nga noteri për kryefamiljarin që ka ndërruar jetë, i cili ka qenë qiramarrës i banesës sipas kontratës së qirasë.

Vlera e plotë privatizimit përbëhet nga vlera e privatizimit të banesës dhe vlera e privatizimit të truallit. Banesa është ndërtim i vitit 1949 dhe nuk ka tarifë privatizimi.

Vlera e truallit për 1 dhomë me sipërfaqe =18 m2, koeficientin e bashkëpronësisë =1,

çmimin e truallit =10801/m2 dhe indeksin e korrigjimit të çmimeve  $i=6,36295139$ ,

është; Vtruallit =123 696 lekë. Vlera e plotë e privatizimit është = 123 696 lekë.

Sa më lart kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë, të miratojë këtë projekt-vendim për ti krijuar mundësinë familjes në fjalë të përfundojë procedurat e privatizimit, me qëllim pajisjen me çertifikatën e pronësisë.

KRYETAR

Ermal Dredha

